<p>ditësh nga përfundimi i lëndës. Në rastet kur është nxjerrë një vendim se një auditor ka shkelur kushtet e dëshmisë së vet nën betim, auditori do të hiqet dhe të gjitha gjetjet e auditorit do të anulohen. Për të kryer një auditim të ri apo auditime që zëvendësojnë raportet e anuluarat të auditimit, do të zgjidhet një auditor i ri.</p> <p>11.1/I Zyra mund të bëjë verifikim të pajtueshmërisë për çdo parregullsi në financat e fushatës dhe raportet e financimit në bazë të ankesave anonime apo ankesave të tjera të parashtruara, informacionit të dhënë nga një institucion publik ose me vendim të Drejtorit të Zyrës. Nëse një proces i verifikimit të pajtueshmërisë është inicuar kundër një auditori, publikimi i raportit të kryer nga ai / ajo do të shtyhet deri pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë.</p> <p>11.1/J Pas shqyrtimit preliminar të ankesës dhe/ose pretendimeve, drejtori i Zyrës mund:</p> <p>i. ta hedhë poshtë kërkesën ose të mos ndërmarrë asnjë veprim të mëtejshëm nëse pretendimet e parashtruara nuk janë serioze, nuk kanë vlerë ose nuk kanë asnjë lloj lidhjeje me kornizën rregullatore të financimit të subjekteve politike, ose</p>	<p>a decision has been issued that an auditor has breached the terms of his affidavit, the auditor will be removed and all of the auditor's findings annulled. A new auditor will be selected to carry out a new audit or audits replacing the annulled audit reports.</p> <p>11.1/I The Office may initiate verification of compliance into any irregularities in the campaign finance and finance reports on the basis of anonymous or other complaints filed, information provided by a public institution or upon a decision by the Director of the Office. If a verification of compliance has been initiated against an auditor, the publication of the report carried out by him/her shall be duly postponed until after the completion of the verification of the compliance process.</p> <p>11.1/J Upon preliminary review of the complaint and/or allegations, the Director of the Office may:</p> <p>i. dismiss the complaint, or take no further action, if allegation put forward are not serious or bear no value or that it does not have any kind of a relation with the political party financing regulatory framework, or</p>	<p>je revizor dao lažnu izjavu, isti se razrešava dužnosti, a njegovi nalazi poništavaju. Za vršenje nove revizije bira se novi revizor koji zamenjuje poništene izveštaje o reviziji.</p> <p>11.1/I Kancelarija može da pokrene proveru nepravilnosti u finansiranju kampanje i finansijskim izveštajima na osnovu anonimne ili druge podnete žalbe, podatka koji dostavi javna institucija ili odluke direktora Kancelarije. Ako je pokrenuta provera u odnosu na revizora, objavljivanje izveštaja istog odlaže se do okončanja postupka provere.</p> <p>11.1/J Nakon preliminarne ocene žalbe i/ili navoda, direktor Kancelarije može da:</p> <p>i. odbije žalbu ili da ne preduzima dalje radnje, ako izneti navodi nisu ozbiljni i nemaju težinu, ili ako se ni na koji način ne odnose na regulatorni okvir za finansiranje politički subjekat, ili</p>
--	---	--

<p>ii. të nxjerrë një vendim për fillimin e verifikimit të përshtatshmërisë nëse konstatohet se ka dëshmi të konsiderueshme të ndonjë parregullsie.</p> <p>11.1/K Pas nxjerrjes së vendimit për fillimin e verifikimit të pajtueshmërisë, drejtori ia cakton lëndën sipas shortit personelit të tij, i cili do të vërtetojë faktet dhe do të mbledhë dëshmi lidhur me parregullsinë e pretenduar. Zyra mund të kërkojë çdo informacion të nevojshëm nga institucionet private ose publike dhe të thërrasë dëshmitarë për të dhënë dëshmi. Përveç kësaj, subjekti politik do të ketë mundësinë të ofrojë, me shkrim dhe personalisht, çdo informacion për mbrojtjen e tyre. Lëndët përfundohen brenda gjashtë (6) muajsh, me mundësi për dy (2) muaj shtesë bazuar në arsyetimin e dhënë me vendim të nxjerrë nga Drejtori.</p> <p>11.1/L Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë, Drejtorit i dorëzohet një raport përfundimtar për të gjitha faktet dhe dëshmitë e grumbulluara, me një rekomandim përfundimtar, bazuar në të cilin Drejtori mund ta nxjerrë vendimin nëse subjekti politik e ka shkelur Ligjin, si dhe t'ia shqiptojë gjobën subjektit politik dhe zyrtarit të saj</p>	<p>ii. Issue a decision to initiate verification of compliance if found that there is substantial evidence of any irregularity.</p> <p>11.1/K Upon issuing the decision to initiate verification of compliance, the Director shall assign the case by lot to his/her staff who will establish the facts and collect evidence related to the alleged irregularity. The Office may request any necessary information from private or public institutions and call in witnesses to provide testimonies. In addition, the political entity shall have the opportunity to provide in written and in person any information in their defense. Cases shall be completed within six (6) months, with the possibility of an additional two (2) months based upon justification provided in a decision issued by the Director.</p> <p>11.1/L Upon completion of the verification of compliance process, the Director shall be provided with a final report on all collected facts and evidence with a final recommendation, based on which the Director may issue the decision on whether a political entity has committed a violation of the Law, as well as issue fines to the political party and its finance officer and /</p>	<p>ii. donese odluku da pokrene proveru ako je zaključeno da postoji dovoljan dokaz o nekoj nepravilnosti.</p> <p>11.1/K Nakon donošenja odluke o pokretanju provere, direktor slučaj žrebom dodeljuje svom osoblju koje utvrđuje činjenice i sakuplja dokaze u vezi sa navodnim nepravilnostima. Kancelarija može da zatraži svaki neophodni podatak od privatnih ili javnih institucija i da poziva svedoke da svedoče. Pored toga, politički subjekat ima mogućnost da u pisanom obliku i lično dostavi svaki podatak u svoju odbranu. Slučajevi se obrađuju u roku od šest meseci, uz mogućnost uvođenja dodatnog roka od dva meseca ako je za to navedeno obrazloženje u odluci direktora.</p> <p>11.1/L Nakon završetka postupka provere, direktoru se dostavlja konačni izveštaj o svim sakupljenim činjenicama i dokazima, zajedno sa preporukom, na osnovu koje isti može da donese odluku o tome da li je politički subjekat izvršio povredu Zakona, kao i da izrekne novčanu kaznu političkom subjektu i finansijskom službeniku istog i/ili</p>
---	--	---

<p>financiar dhe/ose drejtuesit të subjektit politik. Vendimi duhet të përfshijë një përshkrim të shkeljes, datën e veprës dhe gjobën e vendosur.</p> <p>11.1/M Vendimi do të nxirret dhe publikohet në faqen e internetit të KQZ-së. Vendimi mbetet publik në ueb faqen e KQZ-së për një (1) vit pas nxjerrjes së tij. Përveç kësaj, të gjitha palët e përfshira do të informohen zyrtarisht për rezultatin e lëndës.</p> <p>11.1/N Subjekti politik dhe zyrtarët e saj të prekur mund të parashtrojnë padi për konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.</p> <p>11.1/O Nëse gjatë këtij procesi të verifikimit të pajtueshmërisë, ose edhe pas nxjerrjes së vendimit, dyshohet se është kryer një vepër penale, është kryer një shkelje tatimore, ka pasur shkelje të konfliktit të interesit, Zyra menjëherë njofton autoritetin kompetent në Zyrën e Prokurorit, Polici, Administratë Tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, respektivisht, Agjencinë Kundër Korrupsionit.</p> <p>3. Neni 11, paragrafi 11.2 riformulohet dhe pas këtij paragrafi shtohen paragrafët e rinj 11.2/A, 11.2/B, 11.2/C, 11.2/D, 11.2/E dhe 11.2/F si më poshtë:</p>	<p>or head of the political entity. The decision shall include a description of the violation, the date of the offense and the fine issued.</p> <p>11.1/M The decision will be issued and published in the CEC website. The decision shall remain public on the CEC's website for one (1) year after issuance. In addition, all parties involved shall be informed formally on the outcome of the case.</p> <p>11.1/N The political entity and its affected officials may submit a court claim for administrative conflict before the competent court.</p> <p>11.1/O If, during this verification of compliance process, or even after the decision has been issued, there is doubt that a criminal offense has been committed, a tax offense has been committed, a conflict of interest violation has occurred, the Office shall immediately notify the competent authority in the Office of the Prosecutor, Police, Tax Administration, Financial Intelligence Unit, Anti-corruption Agency, respectively.</p> <p>3. Article 11, paragraph 11.2 shall be amended and reworded and new paragraphs 11.2/A, 11.2/B and 11.2/C, 11.2/D, 11.2/E and 11.2/F shall be added after this paragraph, as follows:</p>	<p>rukovodiocu političkog subjekta. Odluka mora da sadrži opis povrede, datum izvršenja povrede i izrečenu kaznu.</p> <p>11.1/M Odluka se donosi i objavljuje na internet portalu CIK. Odluka ostaje javna na internet portalu CIK u roku od jedne godine od dana donošenja. Pored toga, svaka umešana strana se zvanično obaveštava o ishodu slučaja.</p> <p>11.1/N Politički subjekat i zvaničnici istog koji su umešani mogu da pokrenu upravni postupak pred nadležnim sudom.</p> <p>11.1/O Ako se, u toku postupka provere ili čak i nakon donošenja odluke, posumnja da je izvršeno krivično delo, da je izvršen poreski prekršaj, nastao sukob interesa, Kancelarija je dužna da odmah obavesti nadležni organ u Tužilaštvu, odnosno Policiji, Poreskoj upravi, Finansijsko obaveštajnoj jedinici, Agenciji za borbu protiv korupcije.</p> <p>3. Član 11, stav 11, tačka 2. menja se i preformuliše, i posle istog stava dodaju se novi stavovi 11.2/A, 11.2/B, 11.2/C i 11.2/D, i to:</p>
--	--	---

<p>11.2 Drejtori i Zyrës emërohet nga Kryesuesi i KQZ-së, pas konkursit publik për vend të lirë. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Zyrës bëhet sipas legjislacionit të aplikueshëm për emërimë në pozita të larta drejtuese. Drejtori i Zyrës i raporton drejtpërdrejt Kryesuesit të KQZ-së.</p> <p>11.2/A Paneli i rekrutimit përbëhet nga 5 anëtarë, ku Kryesuesi i KQZ-së shërben si kryesues i panelit. Katër anëtarë emërohen nga udhëheqësit e agjencive të pavarura, nga radhët e personelit të lartë menaxhues, sipas ftesës së Kryesuesit të KQZ-së. Komunitetet tjera do të jenë të përfaqësuara në Panel si dhe do të jetë i balancuar në aspektin gjinor.</p> <p>11.2/B Anëtarët e panelit, përveç Kryesuesit të KQZ-së, emërohen nga këto agjenci:</p> <p>1.1 Agjencia Kundër Korrupsionit;</p> <p>1.2 Institucioni i Avokatit të Popullit;</p> <p>1.3 Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave;</p> <p>1.4 Zyra e auditorit të përgjithshëm.</p>	<p>11.2 The Director of the Office shall be appointed by the Chair of the CEC, following a public vacancy. The appointment and dismissal of the Director of the Office is conducted according to the applicable legislation on appointment in senior managerial positions. The Director of the Office reports directly to the Chair of the CEC.</p> <p>11.2/A The recruitment panel, shall be composed of five (5) members, with the Chair of the CEC serving as the head of the panel. The other four members of the panel are appointed by the heads of independence agencies, from the ranks of senior management personnel, as per the invitation of the Chair of the CEC. The panel shall be representative of other communities as well as gender balanced.</p> <p>11.2/B The members of the panel, other than the Chair of CEC, are appointed from the following agencies:</p> <p>1.1 the Anti-Corruption Agency;</p> <p>1.2 the Ombudsperson Institution;</p> <p>1.3 the National Agency for Data Protection; and</p> <p>1.4 The Office of the General Auditor.</p>	<p>11.2 Direktora Kancelarije postavlja predsedavajući CIK, nakon javnog konkursa, u skladu sa zakonom koji je na snazi u odnosu na rukovodeće položaje i isti je neposredno podređen predsedavajućem CIK.</p> <p>11.2/A Komisija za zapošljavanje u slučaju direktora Kancelarije sastoji se od predsedavajućeg CIK koji je i predsednik komisije, i od četiri člana, a koje biraju čelnici nezavisnih agencija, iz redova viših rukovodilaca, a na poziv predsedavajućeg CIK. Komisija mora da u svom sastavu ima i predstavnike zajednica, te da ima uravnoteženu rodnu predstavljnost.</p> <p>11.2/B Članovi panela, osim predsedavajućeg CIK-a, imenuju se od sledećih agencija:</p> <p>1.1 Agencija za borbu protiv korupcije;</p> <p>1.2 Ombudsperson Institucija;</p> <p>1.3 Nacionalna agencija za zaštitu podataka; i</p> <p>1.4 Kancelarija generalnog revizora.</p>
---	---	---

<p>11.2/C Paneli i rekrutimit vendosë për emërim të Drejtorit të Zyrës me shumicë të votave. Procedura për përzgjedhjen e drejtorit të Zyrës përcaktohet në detaje me anë të aktit nënligjor të miratuar nga KQZ-ja, duke i pasqyruar kështu parimet e shërbimit civil.</p> <p>11.2/D Drejtori i Zyrës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1. të jetë qytetar i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë diplomë të vlefshme në shkencat shoqërore;</p> <p>1.3. të ketë së paku tetë (8) vjet përvojë profesionale, nga të cilat pesë (5) vjet në pozita udhëheqëse;</p> <p>1.4. të ketë një reputacion profesional dhe integritet moral;</p> <p>1.5. të mos jetë dënuar për veprë penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;</p> <p>1.6 nuk ka qenë anëtar i një subjekti politik, nuk i ka dhuruar një subjekti politik dhe nuk ka qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me</p>	<p>11.2/C The recruitment panel decides for the appointment of the director of the Office with a majority of votes. The procedure for selection of the Director of the Office is defined in detail by means of a bylaw approved by the CEC thus reflecting the principles of civil service.</p> <p>11.2/D The Director of the Office must meet the following criteria:</p> <p>1.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. have a valid diploma in social sciences;</p> <p>1.3. have at least eight (8) years of professional experience, of which five (5) years in managerial positions;</p> <p>1.4. have a professional reputation and moral integrity;</p> <p>1.5. have not been convicted of criminal offence by a final court decision.</p> <p>11.6 have not been a member of a political entity, have donated to a political entity or have been directly or indirectly in any contractual relation</p>	<p>11.2/C Panel za regrutiranje odlučuje o imenovanju direktora Kancelarije sa većinom glasova. Postupak za izbor direktora Kancelarije detaljno je definisan podzakonskim aktom koji je odobrio CIK tako što odražava principe državne službe.</p> <p>11.2/D Direktor Kancelarije mora da zadovolji sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. Da je državljanin Republike Kosovo;</p> <p>1.2. Da poseduje važeću diplomu u oblasti društvenih nauka;</p> <p>1.3. Da poseduje najmanje osam godina radnog iskustva, od kojih pet na rukovodećim položajima;</p> <p>1.4. Da poseduje profesionalni ugled i moralni integritet;</p> <p>1.5. Da nije osuđen za krivično delo pravosnažnom odlukom suda.</p> <p>1.6 Da nije bio član političkog subjekta, nije davao donacije političkom subjektu ili da nije neposredno ili posredno bio u nikakvom ugovornom odnosu sa</p>
--	--	---

<p>një subjekt politik pesë vjet para paraqitjes së aplikimit të tij/saj.</p> <p>11.2/E Drejtori i Zyrës ushtron detyrat e Zyrtarit Kryesor Administrativ sipas Ligjit për Menaxhimin e Parasë Publike. Paga e Drejtorit të Zyrës do të jetë ekuivalente me pagën e Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së. Kryesuesi i KQZ-së mund të nxjerrë një vendim për alokimin e shtesës për rrezikshmëri për Drejtorin e Zyrës.</p> <p>11.2/F Mandati i Drejtorit është katër (4) vjet me mundësi të riemërimit edhe një (1) herë. Mandati i drejtorit mund të përfundojë me:</p> <p>1.1 skadimin e mandatit; 1.2 dënimin për vepër penale e cila dënohet me burgim prej mbi gjashtë (6) muaj burgim; 1.3 shkarkimin, si pasojë e performancës së dobët, të përcaktuar nga Kryetari i KQZ-së; 1.4 dorëheqje; 1.5 vdekje.</p> <p>11.2/G Nëse Drejtori i Zyrës dështon, të përmbushë një ose më shumë obligime ose kërkesa të vendosura nga ky ligj ose një akt nënligjor, Drejtori i Zyrës</p>	<p>with a political entity five years prior to submitting their application.</p> <p>11.2/E The director of the Office exercises the duties of the Chief Administrative Officer under the Law on Public Money Management. The salary of the Director of the Office shall be equivalent with the salary of the chief executive officer of the CEC Secretariat. The Chair of the CEC may issue a decision to allocate additional hazard payment to the Director of the Office.</p> <p>11.2/F The Director's mandate is five (5) years with the possibility of reappointment even one (1) time. The mandate of the director may be terminated upon:</p> <p>1.1 expiration of the mandate; 1.2 punishment for a criminal act for which the punishment is longer than six (6) months of imprisonment, 1.3 dismissal, upon unsatisfactory performance as established by the CEC Chair; 1.4 resignation; 1.5 death.</p> <p>11.2/G If the Director of the Office deliberately failsto fulfill one or more of the obligations or requirements imposed by this law or by a sub-legal act, the Director of the</p>	<p>političkim subjektom u periodu od pet godina pre nego što je podneo svoju prijavu</p> <p>11.2/E Direktor Kancelarije upražnjava dužnosti glavnog upravnog izvršioca na osnovu Zakona o upravljanju javnim novcem. Zarada direktora Kancelarije jednaka je zaradi glavnog izvršioca Sekretarijata CIK. Predsedavajući CIK može da donese odluku da izdvoji dodatna sredstva za isplatu naknade za opasnost direktoru Kancelarije.</p> <p>11.2./F Mandat direktora traje četiri (4) godina uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.. Mandat direktora može da se prekine u slučaju:</p> <p>1.1 isteka mandata; 1.2 kaznu za krivično delo za koje je kazna duže od šest (6) meseci zatvora, 1.3 razrešenja dužnosti zbog nezadovoljavajućeg učinka, a prema odluci predsedavajućeg CIK; 1.4 ostavke; 1.5 smrti.</p> <p>11.2/G Ako direktor Kancelarije propusti da ispuni jednu ili više obaveza ili zahteva propisanih ovim zakonom ili podzakonskim aktom, direktor</p>
---	--	---

<p>do të shkarkohet nga Kryesuesi. Për qëllime të këtij paragrafi, dështimi në kryerjen e detyrave nënkupton:</p> <p>11.2.G.1 Dështimi në përmbushjen e kërkesave ligjore; 11.2.G.2 Zbulimi i informacioneve konfidenciale ose të ndjeshme personave të paautorizuar; 11.2.G.3 Përfshirja në aktivitete politike ose aktivitete të paligjshme; 11.2.G.4 Përdorimi i pozitës për përfitimet personale; 11.2.G.5 Shkelja e politikave të Zyrës dhe KQZ-se, dhe 11.2.G.6 Shkelja e rëndë e kodit të etikës.</p> <p>11.2.H Shkarkimi i Drejtorit sipas nenit 11.2.F bëhet vetëm si masë e fundit dhe kur është absolutisht e e domosdoshme.</p> <p>4. Paragrafët 11.6 dhe 11.7 shtohen pas paragrafit 11.5 të nenit 11, si më poshtë vijon:</p> <p>11.6 Zyra është e obliguar:</p> <p>a. të botojë dhe mbajë të botuar në ueb faqen e saj zyrtare dhe çdo tremujor raportin tremujor</p>	<p>Office shall be discharged by the Chairperson. For the purposes of this paragraph, failure to perform a task means:</p> <p>11.2.G.1 Failure to meet legal requirements; 11.2.G.2 Disclosure of confidential or sensitive information to unauthorized persons; 11.2.G.3 Involvement in political or illegal activities; 11.2.G.4 Use of position for personal gain; 11.2.G.5 Violation of the policies of the Office and the CEC, and 11.2.G.6 Serious violation of the code of ethics.</p> <p>11.2.H The dismissal of the Director according to article 11.2.F is done only as a last resort and when it is absolutely necessary.</p> <p>4. Paragraphs 11.6 and 11.7 shall be added after paragraph 11.5 of Article 11, as follows:</p> <p>11.6 The Office shall be obliged:</p> <p>a. to publish and keep published quarterly financial report and campaign financial report of</p>	<p>Kancelarije će biti razrešen od strane predsedavajućeg. Za potrebe ovog stava, neizvršavanje zadatka znači:</p> <p>11.2.G.1 Neispunjavanje zakonskih uslova; 11.2.G.2 Otkrivanje poverljivih ili osetljivih informacija neovlašćenim licima; 11.2.G.3 Umešanost u političke ili nezakonite aktivnosti; 11.2.G.4 Korišćenje položaja za ličnu korist; 11.2.G.5 Kršenje politike Kancelarije i CIK-a, i 11.2.G.6 Ozbiljno kršenje etičkog kodeksa.</p> <p>11.2.H Razrešenje direktora u skladu sa članom 11.2.F vrši se samo kao poslednje sredstvo i kada je to apsolutno neophodno.</p> <p>4. Stav 11, tačka 6. i stav 11, tačka 7. dodaje se posle stava 11, tačke 5. člana 11, i to:</p> <p>11.6. Kancelarija je dužna da:</p> <p>a. objavljuje i čuva objavljenim kvartalni finansijski izveštaj i izveštaj o finansiranju kampanje</p>
---	--	--

<p>financiar dhe raportin financiar të fushatës së subjekteve politike.</p> <p>b. të botojë dhe mbajë të botuar në ueb faqen e saj zyrtare raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike, jo më vonë se 30 qershori i vitit vijues.</p> <p>c. t'ia dorëzojë subjektit politik raportin përfundimtar të auditimit, në përputhje me nenin 1 të këtij ligji, deri me 30 qershor të vitit vijues;</p> <p>11.7 Formati i versionit të shkurtër për botim, sipas paragrafit 1.4 të këtij neni, përcaktohet me rregull të veçantë të propozuar nga Zyra dhe të aprovuar nga KQZ-ja.</p> <p>5. Neni 13 i ligjit bazik riformulohet si më poshtë:</p> <p>Pasqyrat financiare të Subjekteve Politike të regjistruara auditohen çdo vit në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>6. Te neni 15, paragrafi 12, pas fjalës "kërkojë KZAP", shtohen fjalët "dhe Zyra".</p>	<p>political entities on its official website, every quarter.</p> <p>b. to publish and keep published the final audit report of political entities on its official website no later than 30th of June of the following year.</p> <p>c. to submit the final audit report to the political entity, in accordance with Article 1 of this Law, by 30th of June of the following year;</p> <p>11.7 The format of the short version for publication, under paragraph 1.4 of this Article, shall be determined by the special rule proposed by the Office and approved by CEC.</p> <p>5. Article 13 of the basic law shall be amended and reworded as follows: Financial statements of a registered Political Entities shall be audited annually in accordance with provisions of the legislation in force.</p> <p>6. Article 15, paragraph 12, after "require the ECAC" the words "and the Office" are added.</p>	<p>političkih subjekata na svom zvaničnom internet portalu;</p> <p>b. objavljuje i čuva objavljenim konačni izveštaj o reviziji političkih subjekata na svom zvaničnom internet portalu najkasnije do 30. juna naredne godine.</p> <p>c. da političkom subjektu dostavi konačni izveštaj o reviziji, u skladu sa članom 1. ovog Zakona, do 30. juna naredne godine;</p> <p>11.7 Oblik kratke verzije za objavljivanje, iz stava 1, tačka 4. ovog člana, određuje se posebnim pravilom koji Kancelarija predlaže CIK na usvajanje.</p> <p>5. Član 13. osnovnog zakona menja se i preformuliše, tako da glasi: Revizija finansijskih izveštaja registrovanih političkih subjekata vrši se jednom godišnje u skladu sa odredbama zakona koji je snazi.</p> <p>6. U članu 15, stav 12, posle reči „od IKŽM“ dodaju se reči „i od Kancelarije“.</p>
---	---	--

<p>7. Te neni 18, paragrafi 3, pas fjalës "vendosjes nga KQZ", shtohet shenja e pikësimit dhe fjalët "Zyra".</p> <p>8. Te neni 19, paragrafi 2, pas fjalës "vendosjes nga KQZ", shtohet shenja e pikësimit dhe fjalët ", Zyra".</p> <p>9. Te neni 29, paragrafi 1, pika [r], pas fjalës "vendosjes nga KZAP", shtohet shenja e pikësimit dhe fjalët "Zyra".</p> <p>10. Neni 38, paragrafi 2, ndryshohet dhe riformulohet si vijon:</p> <p style="padding-left: 40px;">38.2. Shuma e gjobës përcaktohet në bazë të nenit 126 të ligjit bazik.</p> <p>11. Neni 41 i ligjit bazik [Auditimi] shfuqizohet.</p> <p>12. Neni 42 [Sanksionet] ndryshohen dhe riformulohet si më poshtë:</p> <p style="padding-left: 40px;">42.1 Zyra do të shqiptojë gjoba në pajtim me rregullat, kundër subjekteve politike që paraqesin Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës pas afatit të zbatueshëm. Zyra do të derdhë çdo gjobë që mbledh sipas këtij ligji në Buxhetin e Kosovës.</p>	<p>7. Article 18, paragraph 3, after “imposed by the CEC”, the punctuation mark and the words “the Office” are added.</p> <p>8. Article 19, paragraph 2, after “imposed by the CEC”, the punctuation mark and the words “, the Office” are added.</p> <p>9. Article 29, paragraph 1, item [r], after “imposed by the ECAC”, the punctuation mark and words “, the Office” are added.</p> <p>10. Article 38, paragraph 2, shall be amended and reworded as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">38.2. The amount of the fine is determined on the basis of Article 126 of the basic Law.</p> <p>11. Article 41 [Audit] of the basic law shall be repealed.</p> <p>12. Article 42 [Sanctions] shall be amended and reworded as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">42.1 The Office shall issue fines in accordance with rules, against Political Entities that submit Campaign Financial Disclosure Reports after the applicable deadlines. The Office shall remit any fines that it collects here under to the Kosovo Consolidated Budget.</p>	<p>7. U članu 18, stav 3, posle reči „izrečene od strane CIK“ dodaju se znak interpunkcije i reči „Kancelarije“.</p> <p>8. U članu 19, stav 2, posle reči „izrečene od strane CIK“ dodaju se znak interpunkcije i reči „, Kancelarije“.</p> <p>9. U članu 29, stav 1, tačka r), posle reči „od strane IKMŽ“ dodaju se znak interpunkcije i reči „, Kancelarije“.</p> <p>10. Član 38, stav 2. menja se i preformuliše na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">38.2. Iznos novčane kazne utvrđen je na osnovu člana 126 osnovnog zakona.</p> <p>11. Opoziva se član 41 (Revizija) osnovnog zakona.</p> <p>12. Član 42 (Kazne) menja se i preformuliše na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">42.1. Kancelarija izriče novčane kazne u skladu sa pravilima, političkim subjektima koja dostave izveštaj o finansiranju kampanje po isteku važećeg roka. Kancelarija svaku novčanu kaznu koju naplati u skladu sa istim uplaćuje u Budžet Kosova.</p> <p style="padding-left: 40px;">42.2. Novčana ili druga kazna koju izreknu CIK ili Kancelarija nije na štetu</p>
--	--	--

<p>42.2 Vendosja e një gjobe ose sanksioni tjetër nga KQZ-ja ose Zyra nuk paragjykon ndonjë sanksion penal që mund të zbatohet.</p> <p>42.3 Subjekti politik mund të apelojë vendimin e KQZ-së ose të Zyrës për vendosjen e gjobës pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë brenda pesë (5) ditëve të punës pas njoftimit të vendimit.</p> <p>42.4 Gjykata e shkallës së parë nuk vendos sanksione në lidhje me një çështje që i nënshtrohet një gjobe të lëshuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p>42.5 Subjektet politike duhet t'i paraqesin Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës që paguar.</p> <p>13. Neni 64, paragrafi 64.2, pika (d) ndryshohet dhe riformulohet si vijon:</p> <p>d) Siguron që Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike të ketë burime për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;</p> <p>14. Te neni 65, paragrafit 65.2, fshihet fjalia e parë.</p>	<p>42.2 The imposition of a fine or other sanction by the CEC or the Office does not prejudice any criminal sanction that may apply.</p> <p>42.3 A Political Entity may appeal a decision of the CEC or the Office imposing a fine to the competent court of first instance within five (5) working days of being notified of the decision.</p> <p>42.4 The court of first instance shall not impose a sanction in respect of a matter that is subject to a fine issued under paragraph 1 of this Article.</p> <p>42.5 Political entities shall submit to the Office a copy of the payment slip for the fine that they have paid.</p> <p>13. Article 64, paragraph 64.2, point (d) shall be amended and reworded as follows:</p> <p>d) Ensures that the Office for Registration, Certification and Financial Control of Political Entities is provided with resources to meet the obligations set forth in this Law;</p> <p>14. Article 65, paragraph 65.2, the first sentence</p>	<p>nijedne krivične sankcije koja može da se izrekne.</p> <p>42.3 Politički subjekat ima pravo da se žali na odluku CIK ili Kancelarije kojom je izrečena novčana kazna, kod nadležnog prvostepenog suda, u roku od pet radnih dana od dana obaveštavanja o odluci.</p> <p>42.4. Prvostepeni sud ne može da izriče kaznu u vezi sa stvari koja je predmet novčane kazne izrečene u skladu sa stavom 1. ovog člana.</p> <p>42.5. Politički subjekat je dužan da Kancelariji dostavi primerak priznanice o uplaćenju novčanoj kazni.</p> <p>13. Član 64, stav 2, tačka d) menja se i preformuliše na sledeći način:</p> <p>d) obezbediti da su Kancelariji za registraciju, potvrdu i finansijsku kontrolu političkih subjekata obezbeđeni resursi za vršenje obaveza predviđenih ovim Zakonom;</p> <p>14. Briše se član 65, stav 2, prva rečenica</p>
--	--	--

<p>15. Neni 122, paragrafi 1, pika (e) shfuqizohet.</p> <p>16. Te neni 126, paragrafi 126.1 fshihet, ndërsa paragrafi 126.2 pas fjalës “rregullave” në fund të fjalisë, shtohen fjalët “që janë jashtë fushëveprimit të financimit të subjekteve politike”.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që bien ndesh me dispozitat e këtij ligji dhe të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjin Nr. 04/L-122 dhe Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Dispozitat kalimtare</p> <p>Personeli ekzistues dhe asetet e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike i transferohen Zyrës së re të themeluar me këtë ligj.</p>	<p>15. Article 122 paragraph 1, item (e) is repealed.</p> <p>16. In Article 126, paragraph 126.1 is deleted, while paragraph 126.2 after the word "rules" at the end of the sentence, the words "which are outside the scope of financing of political entities".</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Repeal and supersede</p> <p>With the entry into force of this Law all legal provisions stipulated in the Law no. 03/L-174 on the Financing of Political Entities, as amended and supplemented by the Law no. 04/L-058, Law no. 04/L-122 and Law no. 03/L-073 on General Elections in the Republic of Kosovo, amended and supplemented by the Law no. 03/L-256 that conflict with provisions of this Law are superseded.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Transitional Provision</p> <p>The existing staff and property of the Office for the Registration of Political Parties shall be transferred into the new Office as established by the present law.</p>	<p>15. Član 122, stav 1, tačka (5) se opoziva.</p> <p>16. U članu 126. stav 126.1. briše se, dok se u stavu 126.2. posle reči „pravila” na kraju rečenice dodaju reči „koji su van okvira finansiranja političkih subjekata”.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Opoziv</p> <p>Stupanjem na snagu ovog Zakona menja se svaka odredba iz Zakona br. 03/L-174 o finansiranju političkih subjekata, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 04/L-058, Zakonom br. 04/L-122 i Zakona br. 03/L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 03/L-256, a koja je u suprotnosti sa odredbama ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Prelazne odredba</p> <p>Postojeće osoblje i imovina Kancelarije za registraciju političkih stranaka prebace se na novoj kancelariju utvrđenu ovim zakonom.</p>
--	---	---

<p align="center">Neni 6 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 6 Entry into force</p>	<p align="center">Član 6 Stupanje na snagu</p>
<p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <p align="center">_____</p> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>This law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <p align="center">_____</p> <p>Assembly President of the Republic of Kosovo</p>	<p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u službenom listu Republike Kosovo.</p> <p align="right">Glauk Konjufca</p> <p align="center">_____</p> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>